



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

STUDIM: PERCEPTIMI I ZGJEDHËSVE LIDHUR ME INFLUENCAT E PALËVE TË TRETA NË ZGJEDHJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Publikuar më 02 Mars 2024

STUDIM:
PERCEPTIMI I ZGJEDHËSVE LIDHUR ME
INFLUENCAT E PALËVE TË TRETA NË
ZGJEDHJE

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj
2023

STUDIM: PERCEPTIMI I ZGJEDHËSVE LIDHUR ME INFLUENCAT E PALËVE TË TRETA NË ZGJEDHJE

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikim ligjor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Trajtesa politike:

Znj. Anda Kruetani, Koordinatorë Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit *“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”*, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Institutin e Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit apo partnerëve të tjerë zbatues.

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania

PO BOX no.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
METODOLOGJIA E ANKETIMIT	9
1.INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË ANKETUARIT.....	11
2.NJOHURITË E PËRGJITHSHME.....	13
3.SHITBLERJA E VOTËS.....	16
4.SHPËRDORIMI I ASETVE PUBLIKE	23
5.DENONCIMET DHE BESUESHMËRIA E ZGJEDHËSVE TEK INSTITUCIONET	33
6. FINANCIMET E DYSHIMTA TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE (PARTIVE POLITIKE).....	39
SHTOJCA A: Format i pyetësorit	42

HYRJE

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore.

Në përputhje me misionin e tij, për të kontribuar për zgjedhje të lira dhe të ndershme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është angazhuar prej vitit 1996 në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare dhe atyre të qeverisjes vendore. Ky monitorim u realizua edhe ndaj zgjedhjeve të qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023. Raporti përfundimtar i monitorimit të këtyre zgjedhjeve mund të aksesohet në këtë lidhje: [Raport Përfundimtar mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Monitorimit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore \(ahc.org.al\)](https://ahc.org.al/Raport-Përfundimtar-mbi-Gjetjet-dhe-Rekomandimet-e-Monitorimit-të-Zgjedhjeve-për-Organet-e-Qeverisjes-Vendore).

Paralelisht me monitorimin e procesit zgjedhor të zgjedhjeve të dt.14 Maj 2023, vëzhguesit dhe korrespondentët e KShH-së u angazhuan gjithashtu në anketimin e zgjedhësve lidhur me influencat e palëve të treta në këto zgjedhje. Influncat apo ndikimet e palëve të treta të cilat janë marrë parasysh në kontekst të këtij raporti janë ato të cilat cenojnë standartet kushtetuese të votës, e cila duhet të jetë vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Këto ndikime mund të ushtrohen nga faktorë të jashtëm ose të brendshëm duke avantazhuar në mënyrë të padrejtë apo të pandershme subjekte të caktuar zgjedhore ose kandidatë të tyre.

Influencat e jashtme mund të vijnë si rezultat i ndikimeve nga shtete të tjera të njohura për regjimet diktatoriale ose autokrate, duke sjellë edhe efekte destabilizuese në drejtim të demokracisë dhe shtetit ligjor. Nga ana tjetër, influencat e brendshme, mund të vijnë për shkak të ndikimeve që mund të kenë aktorë të brendshëm si partitë politike, zyrtarët publikë e deri tek persona të dyshuar apo të përfshirë në krimin e organizuar. Si rrjedhojë e këtij ndikimi, ndaj qytetarëve mund të ushtrohet presion nëpërmjet mjeteve të ndryshme për të votuar në favor të një subjekti zgjedhor të caktuar, duke vepruar në mënyra dhe forma të ndryshme të kundërligjshme si shpërdorimi i aseteve publike, kanosja apo shitblerja e votës.

Për matjen e perceptimit të zgjedhësve sa i takon influencave në zgjedhjet vendore të 14 maj 2023, vëzhguesit dhe korrespondentët e KShH-së (anketuesit) u angazhuan në 14 Bashki të vendit, duke intervistuar një kampion të caktuar zgjedhësish, gjatë periudhës maj-qershor 2023.

Ky sondazh u realizua në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë. Kjo nismë po zbatohet nga një partneritet organizatash vendase: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Gjetjet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport nuk pasqyrojnë detyrimisht opinionet dhe mendimet e organizatave të tjera partnere dhe Ambasadës Britanike në Tiranë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky sondazh reflekton të dhënat cilësore dhe sasiore të marra nga intervistat e realizuara nga vëzhguesit dhe korrespondentët e KShH-së me një kampion prej 1087 zgjedhësish, në Bashkitë Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë, duke përfaqësuar kështu 12 qarqet përbërëse të vendit.

Njohuritë e zgjedhësve për legjislacionin

Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta, shumica e zgjedhësve (rreth 58.69%) deklarojnë se janë të informuar sa i takon parashikimeve ligjore, duke i cilësuar njohuritë e tyre pohojnë të mira, shumë të mira apo të shkëlqyeshme.

Sa i takon influencave të ushtruara nga faktorë të brendshëm gjatë zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj 2023, zgjedhësit e intervistuar pohuan se partitë politike renditen të parat (36.48%), ndjekur nga krimi i organizuar (29.58%). Faktori i tretë i brendshëm në pohimet e 19.7% të të anketuarve janë influencat e zyrtarëve publike që punojnë në institucione shtetërore, të cilët ushtrojnë presion mbi administratën publike dhe familjarët e tyre.

Sa i takon influencave të jashtme, dhe ndërhyrjes në mënyrë të padrejtë të shteteve të huaja në proceset zgjedhore në Shqipëri, pjesa më e madhe e të anketuarve, 49.8% e tyre perceptojnë se ka ndërhyrje të tilla. Shtetet të cilat evidentohet se ndikojnë më së shumti në proceset zgjedhore në Shqipëri janë Rusia (25.38%), Turqia (19.13%), Kina (10.86%), Irani (10.39%), të kritikuar në arenën ndërkombëtare si shtete me regjime diktatoriale ose autokrate.

Shitblerja e votës

Shitblerja e votës e njohur ndryshe si korrupsioni aktiv dhe korrupsioni pasiv në zgjedhje është vepër penale dhe dënohet nga 1 deri në 5 vjet burg, përkatësisht sipas neneve 328 dhe 328/b të Kodit Penal. Nga të dhënat rezulton shqetësues fakti se rreth 209 të anketuar apo 19.2% e tyre kanë pohuar se kanë marrë oferta si para, ushqime apo premtime në këmbim të votës, kundrejt 74.5% të cilët mohojnë veprime të tilla.

Duke marrë në konsideratë se ndonjëherë qytetarët mund të ndihen të paragjykuar apo të frikësuar për të pohuar se u janë ofruar përfitime të ndryshme në këmbim të votës, anketuesit pyetën zgjedhësit nëse ata kishin dijeni për persona të rrethit të tyre familjar apo shoqëror të cilëve u janë ofruar përfitime si para, produkte të ndryshme apo premtime. Në ndryshim nga pohimet më sipër për eksperiencën personale, 44.71% e të anketuarve apo 486 prej tyre pohuan se kanë dijeni për oferta të ndryshme në këmbim të votës që u janë bërë rrethit të tyre familjar e shoqëror, kundrejt 46.55% e të anketuarve, të cilët e mohuan një gjë të tillë.

Për zgjedhësit që pranojnë shitblerjen e votës, mjeti kryesor që ofrohet në këmbim të votës janë paratë (39.03%). Ofrimi i një vendi pune për veten apo familjarët është një tjetër mjet (25.31%), kundrejt 16.76% të anketuarve të cilët pohuan si mjet, presionin për të mbajtur vendin e punës apo për të mos marrë pjesë në votime. Pjesa tjetër e të anketuarve pohuan se u janë ofruar edhe ushqime e ndihma materiale (16.54%) ndërsa një pjesë më e vogël (2.36%) pohojnë si formë influence, kërcënimet nga persona të dyshuar apo të përfshirë në veprimtari kriminale.

Sa i takon 19.2% të zgjedhësve që pranojnë se ju është ofruar një e mirë materiale apo premtim në këmbim të votës, rezulton se në 42.75% të rasteve, ndikues kanë qënë ‘patronazhistët’. Të dytët të renditur, sipas pohimeve të 27.45% e të anketuarve që pranojnë këtë fenomen, janë zyrtarët publike. Ndikues të tjerë janë edhe kandidatët për kryetarë bashkie apo këshilla bashkiakë (12.67%), biznesmenë (10.72%) si dhe persona të njohur për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale (6.41%).

Fotografimi i votës është një fenomen i cili shkel parimin e fshehtësisë së votimit. Pjesa më e madhe e të anketuarve pohuan se nuk i është kërkuar fotografimi i votës së tyre. Ndërkohë, 6.7% të të anketuarve u është kërkuar të fotografojnë votën dhe 4% kanë refuzuar të përgjigjen.

Fushata Zgjedhore dhe Shpërdorimi i aseteve publike

Anketuesit pyetën zgjedhësit nëse kishin marrë pjesë në takime me natyrë fushate elektorale para datës 13 Prill, që përkon me afatin zyrtar të nisjes së fushatës elektorale. Nga të dhënat rezulton se 1 në 4 të anketuar (25.5%) pohuan se kanë qënë pjesëmarrës në takime gjatë fushatës elektorale kundrejt 63.5% të të anketuarve që mohuan marrjen pjesë në këto aktivitete.

Anketuesit pyetën zgjedhësit të cilët janë të punësuar në administratën publike nëse ishin detyruar të marrin pjesë në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e 14 maj 2023. Pjesa më e madhe të anketuarve (57.5%) mohuan diçka të tillë, ndërkohë që 9.5% e të anketuarve pohuan se janë detyruar të marrin pjesë në fushatën për këto zgjedhje vendore gjatë orarit të punës në shkelje të nenit 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Rreth 17.8% pohuan se janë detyruar të marrin pjesë, por jashtë orarit të punës.

Gjatë fushatës zgjedhore gjithashtu ndalohej marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Nga të dhënat rezulton se më shumë se gjysma e të anketuarve apo 57% kanë pohuar se nuk kanë dijeni të rasteve të tilla. Ndërkohë, rreth 35.2% e të anketuarve kanë pohuar se janë në dijeni të punësimeve gjatë periudhës një mujore ose disa muaj para zgjedhjeve të datës 14 maj 2023.

Një nga format e përdorimit të aseteve publike për qëllime zgjedhore lidhet me kryerjen e investimeve të ndryshme në shërbimet publike në periudhën para datës së zgjedhjeve. Nga të

dhënat e anketimit, rezulton se më shumë se 1 në 2 të anketuar apo 57.9% e tyre pohojnë se kanë vënë re përmirësime të kryera në infrastrukturën rrugore (shtrimet e rrugëve, krijimi i korsive të biçikletave, ndriçimi i rrugëve, vijat e bardha etj), investime në fasada pallatesh, hapësira publike apo rikonstruksione të ndryshme, krijimi i hapësirave të gjelbërta etj. Gjithashtu, një pjesë e këtyre zgjedhësve raportuan përsheptimin e mbarimit të punimeve të investimeve me qëllim përfundimin e tyre para zgjedhjeve. Në një vështrim krahasues të bashkive ku evidentohet më së shumti prania e investimeve dhe përmirësimeve publike, rezulton se bashkia Kukës kryeson me 89.19% të të anketuarve të cilët kanë pohuar një fenomen të tillë ndjekur nga bashkia e Shkodrës (84.09%), bashkia e Kamzës (80%) dhe e Lezhës (79.59%). Nga bashkitë ku një fenomen i tillë është mohuar nga shumica e zgjedhësve janë bashkia Gjirokastrë (72.73%), Fier (65.6%), Vlorë (61.19%), Pogradec (55%).

Denoncimet tek institucionet që hetojnë dhe sanksionojnë shkeljet e legjislacionit zgjedhor

Pavarësisht njohurive të konsiderueshme për shkeljet në fushën e zgjedhjeve, të dhënat nga anketimi tregojnë se vetëm një pjesë e vogël e zgjedhësve denoncojnë shkeljet e evidentuara. Kështu, 49.5% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë denoncuar pasi nuk kanë qenë në dijeni të ndonjë shkeljeje. Kjo e dhënë është kontradiktore në raport mbi perceptimet e tyre në raport me shkeljet e pohuara sipas pyetjeve të tjera të pyetësorit. Shqetësues mbetet fakti se edhe pse rreth 43.7% e të anketuarve kanë pohuar se janë në dijeni të shkeljeve, nuk kanë bërë asnjë denoncim apo ankesë. Vetëm 4.57% e të anketuarve kanë denoncuar shkelje në fushën e zgjedhjeve duke ju drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me ankesë ose institucioneve të policisë apo prokurorisë me kallëzim penal.

Sa i takon arsyeve se pse qytetarët hezitojnë të denoncojnë shkeljet përmenden mungesa e besimit, neglizhimi i situatës, frika nga pasojat dhe mungesa e informacionit se ku të drejtohen për të denoncuar.

Anketuesit pyetën zgjedhësit lidhur me vlerësimin e tyre mbi veprimtarinë e organit të Prokurorisë. Nga të dhënat, rezulton se 1 në 2 persona apo 50.23% e të anketuarve perceptojnë se Prokuroria nuk i heton krimet zgjedhore në mënyrë të menjëhershme dhe të paanshme. Zgjedhësit e anketuar, të cilët nuk besojnë në hetimin e krimeve zgjedhore nga Prokuroria janë të përqendruar kryesisht në qytetet e Shkodrës (79.55%), Beratit (76.09%), Lezhës (73.49%) dhe Durrësit (65.45%).

Financimet e dyshimta të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore

Anketuesit pyetën zgjedhësit se si i konsideronin ata shpenzimet që partitë politike kanë bërë për fushatën zgjedhore për zgjedhjet vendore të 14 maj 2023. Rezulton se shumica e të anketuarve, rreth 55.1% e tyre i vlerësojnë shpenzimet për fushatë si të tepruara apo shumë të tepruara, ndërkohë që 28.89% e të anketuarve i konsiderojnë shpenzimet e kryera si normale.

Anketuesit pyetën zgjedhësit për financime të dyshimta të partive politike apo kandidatëve të tyre. Pjesa më e madhe, rreth 71.30% e të anketuarve nuk kanë dijeni për financime të paligjshme kundrejt 26.77% të anketuarve që pohuan se kanë dijeni. Nga të anketuarit që deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë se kanë dijeni për burime të dyshimta, 82% e tyre u shprehën se burimi kryesor i financimeve të paligjshme vjen si rezultat i korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndjekur nga 9.89% që rendisin bizneset si financues dhe një numër i ulët, me afro 7% mendojnë se burimet e financimit janë nga Rusia. Të pyetur se nga i disponojnë këto informacione, të anketuarit rendisin si burimin kryesor lajmet në media, ndjekur më pas nga burime të tjera si informacionet nga personat e angazhuar në veprimtari politike, rrjetet sociale, familjarët apo miqtë e tyre, si dhe në disa prej rasteve si rrjedhojë e angazhimit të tyre direkt në fushatën zgjedhore, ku janë më të ekspozuar ndaj informacioneve të tilla.

METODOLOGJIA E ANKETIMIT

Me kontributin e ekspertëve të fushës dhe një eksperti statisticien, u hartua një pyetësor me 25 pyetje, të cilat morën në konsideratë problematikat e vërejtura në drejtim të influencave në proceset zgjedhore, vitet e fundit në vendin tonë. Më tej, u zhvillua një trajnim i posaçëm, me rrjetin e vëzhguesve dhe korrespondentëve të KShH-së, të cilët anketuan zgjedhësit në terren.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në anketë

Në këtë anketë morën pjesë 1087 të anketuar. Përzgjedhja e të anketuarve është kryer në mënyrë të rastësishme duke marrë në konsideratë gjithëpërfshirjen e karakteristikave, si: gjinia, grupmosha (18 vjeç e sipër), rajoni gjeografik etj. Paraprakisht, KShH, realizoi një planifikim mbi metodologjinë dhe kuotat e parashikuara për secilin rajon gjeografik në vend bazuar mbi të dhënat e popullsisë në bashkitë që ishin në vëmendje të pyetësorit.

Mbledhja e të dhënave u zhvillua në terren, ndërsa për të ruajtur saktësinë e të dhënave gjatë analizës u përdor platforma elektronike *Google Form*. Gjatë mbledhjes së të dhënave, anketuesit morën pëlqimin e zgjedhësve duke i informuar ata se pjesëmarrja në anketë ishte vullnetare, si dhe se, në përputhje me legjislacionin shqiptar, asnjë e dhënë personale e përpunuar nuk do të shpërndahej dhe se i gjithë informacioni i dhënë gjatë intervistës do të përdorej vetëm për qëllim të analizës së të dhënave në këtë studim.

Përcaktimi i mostrës

Anketimi u realizua me individë të moshës 18 vjeç e sipër, duke marrë në konsideratë qëllimin e sondazhit lidhur me zgjedhjet dhe moshën minimale në Shqipëri për t'u konsideruar zgjedhës. KShH zhvilloi një analizë paraprake duke marrë në konsideratë shpërndarjen në përqindje të popullsisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët i përkasin kësaj kategorie moshe. Nga të dhënat e INSTAT rezulton se popullsia 18 vjeç e sipër në Shqipëri përbën përafërsisht 80% të popullsisë totale në vend.¹ Nga mbledhja e të dhënave rezulton se përqëndrimi më i lartë, i cili reflekton edhe përqëndrimin më të lartë të popullsisë, është në qarkun e Tiranës, ndërkohë përqëndrimi më i ulët i të anketuarve është në qarkun e Gjirokastrës.²

Qarku	Gjirokastrë	Dibër	Berat	Korçë	Fier	Vlorë	Shkodër	Lezhë	Durrës	Elbasan	Tiranë	Kukës	Total
-------	-------------	-------	-------	-------	------	-------	---------	-------	--------	---------	--------	-------	-------

¹ Tab.1 gjendur në aneks të dokumentit referencë nga INSTAT, viti 2023)


² Shënim: Bashkitë Kavajë, Librazhd, Lushnjë, Mat, Përmet kanë 1 të anketuar; bashkitë Peqin, Poliçan dhe Përrenjas kanë 2 të anketuar ndërsa bashkia Tepelenë ka 3 të anketuar. Këto bashki nuk janë paraqitur në disa prej tabelave përmbledhëse pasi numri i të anketuarve ka qënë relativisht i ulët dhe jo përfaqësues. Arsyeja pas këtyre anketimeve të limituara qëndron në targetimin e pyetësorit ndaj 14 Bashkive subjekt monitorimi.

Target	20	39	41	71	100	66	69	42	104	93	329	26	1000
Nr minimal	12	24	25	42	60	40	41	25	63	56	197	16	600
Realizimi	26	52	48	91	126	67	85	49	110	107	289	37	1087

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË ANKETUARIT

Në pyetësor u përfshinë 1087 zgjedhës me të drejtë vote, nga të cilët 52.8% i përkasin gjinisë femërore dhe 46.9% gjinisë mashkullore. 0.3% e të anketuarve (3 persona) preferojnë të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve



Gjatë mbledhjes së të dhënave në terren, ju kushtua vëmendje gjithëpërfshirjes së të gjithë grupmoshave (Figura 2). Kështu, pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç (22.08%); 18-25 vjeç (21.71%) dhe 36-45 vjeç (19.78%) të cilat përbëjnë pothuajse 64% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë përafërsisht 9.47% të individëve të intervistuarve.

Figura 2. Të anketuarit sipas grupmoshave





Figura 3. Të anketuarit sipas Nivelit arsimor




Sa i takon arsimimit të të anketuarve, rezulton se 52.71% e të anketuarve kanë arsim të lartë, respektivisht diplomë universitare (41.95%) dhe diplomë pasuniversitare (10.76%), ndjekur nga të anketuar me arsimin të mesëm të lartë (gjimnaz) të cilët përbëjnë 26.59%. Përfaqësimi më i vogël i pjesëmarrësve në anketim i përket arsimin të mesëm të ulët (klasa 6-9), me 7.18%.

Lidhur me situatën e tyre të punësimit gjatë zbatimit të anketimit rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve (28.06%) janë të punësuar në sektorin privat ndjekur nga 19.32% e të anketuarve të cilët punojnë në sektorin publik. 136 prej të anketuarve (12.51%) janë studentë, ndërkohë që 199


prej të intervistuarve (18.31%) rezultojnë të papunë. Rreth 16.19% e të anketuarve deklarojnë se janë të vetëpunësuar.

Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve



Nisur nga qëllimi i anketimit sa i takon influencave të palëve të treta në zgjedhje, KShH ka identifikuar edhe shpërndarjen e të anketuarve në bashkitë ku ata janë zgjedhës. Të dhënat e mbledhura për këtë seksion reflektojnë edhe përqëndrimin më të madh të popullsisë në bashkitë e vendit. Kështu, Bashkia Tiranë përmban përqindjen më të lartë të të anketuarve (26.03%) të regjistruar si zgjedhës në këtë bashki ndjekur nga bashkia Fier e cila përmban 11.50%, Durrësi 10.12% dhe Elbasani 9.38% të zgjedhësve të anketuar. Pjesa më e vogël e zgjedhësve të anketuar është e përqendruar në Gjirokastrë.

Figura 5. Përfaqësimi i të anketuarve në Bashkitë ku janë të regjistruar si zgjedhës:



Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetësi, u analizuan në tërësi, fillimisht në nivel kombëtar dhe më tej në veçanti sipas qarkut, grupmoshës dhe nivelit të arsimit. Kjo analizë u krye për të vërejtur dallimet midis këtyre grupeve të ndryshme të popullsisë në lidhje me temat specifike që trajton anketa.


2.NJOHURITË E PËRGJITHSHME

Njohja e legjislacionit të vendit tonë në përgjithësi dhe atij zgjedhor në veçanti është thelbësore për funksionimin e një demokracie të shëndetshme dhe për përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset politike. Këto njohuri i japin qytetarëve aftësinë të kuptojnë dhe të ndikojnë në zgjedhjet e lira e të ndershme në mënyrë të përgjegjshme. Njohja e legjislacionit zgjedhor i lejon qytetarët që të marrin vendime të informuara jo vetëm rreth zgjedhjes së kandidatëve dhe kriterëve penguese sikurse janë ato që rrjedhin nga legjislacioni për dekriminalizimin, por njëkohësisht për:

- Identifikimin e shkeljeve zgjedhore: duke patur dijeni rreth parashikimeve ligjore qytetarët mund të evidentojnë më lehtë shkeljet e mundshme të rregullave zgjedhore dhe t'i denoncojnë ato.
- Mbikëqyrjen e procesit zgjedhor: Qytetarët me njohuri të legjislacionit zgjedhor mund të jenë pjesë e mbikëqyrjes së procesit zgjedhor dhe të ndihmojnë në sigurimin e transparencës dhe integritetit të zgjedhjeve, qoftë dhe nëpërmjet iniciativës individuale dhe rastësore.


Për të siguruar informimin e qytetarëve lidhur me parashikimet ligjore të legjislacionit zgjedhor është i nevojshëm edukimi i vazhdueshëm i tyre. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në nenin 19 të tij ka ngarkuar me këtë detyrë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të ndjeshme që janë shënuar në zgjedhjet e fundit lidhur me këtë kompetencë, sërish kjo mbetet e pamjaftueshme në raport me nevojat reale të edukimit të zgjedhësve. Gjithsesi ky process është i pamjaftueshëm, nisur nga praktika e zgjedhjeve të kaluara.

Figura 6.1 Si i vlerësoni njohuritë që keni për legjislacionin zgjedhor?




Legjislacioni zgjedhor në vendin tonë, përfshirë Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme në tri dekadat e fundit. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor, një fenomen i hasur shpesh në shtetin shqiptar, ndikojnë drejtpërdrejt në njohuritë që qytetarët kanë mbi parashikimet ligjore në këtë legjislacion, duke i konfuzuar këta të fundit. Në kuadër të të dhënave të anketimit rezultoi se pavarësisht ndryshimeve të shpeshta, qytetarët shqiptarë vlerësojnë se janë të informuar sa i takon parashikimeve ligjore pasi pjesa më e madhe e të anketuarve, rreth 58.69% e tyre pohojnë se kanë njohuri të mira, shumë të mira apo të shkëlqyeshme rreth parashikimeve ligjore krahasuar me të anketuarit që kanë njohuri të dobëta, të cilët përbëjnë 12.24% të të anketuarve dhe 29.07% të cilët pohojnë se kanë njohuri të mjaftueshme. Në sajë të parimit të besueshmërisë së të dhënave, vlen për t'u përmendur se këto rezultate janë përfaqësim i drejtpërdrejtë i vetëvlerësimit të njohurive nga qytetarët dhe kështu mund të mbartin elementë subjektivë të paragjyqimeve të vetvetes, qofshin këto me tendencë pozitive apo negative.

Figura 7.1. A mendoni se shtete të huaja ndërhyjnë në mënyrë të padrejtë në proceset zgjedhore në Republikën e Shqipërisë?




KShH pyeti të anketuarit lidhur me njohurinë apo përshtypjet e tyre për ndërhyrje të shteteve të huaja në zgjedhjet në Shqipëri. Sa i takon ndërhyrjes në mënyrë të padrejtë të shteteve të huaja në proceset zgjedhore në Republikën e Shqipërisë, pjesa më e madhe e të anketuarve, 49.8% prej tyre mendojnë se ka ndërhyrje të tilla ndërkohë që 30.9% mendojnë se nuk ka prani të ndërhyrjeve të huaja. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 210 persona (19.3%) pohojnë se nuk kanë dijeni sa i takon ndërhyrjeve të shteteve të huaja në proceset zgjedhore.

Figura 7.2. Nëse po, cilat nga këto shtete mendoni se ndikojnë në mënyrë të padrejtë në zgjedhjet në vendin tonë?



Nga 541 të anketuarit të cilët pohuan se ka ndërhyrje të padrejta të shteteve të huaja në proceset zgjedhore në Republikën e Shqipërisë, 25.38% e tyre mendojnë se ndërhyrjet janë nga Rusia, ndjekur nga 19.13% që listojnë si shtet të dytë të renditur me numrin më të lartë të votave, Turqinë, e ndjekur nga Kina (10,86%) dhe Irani (10.39%). Ndërkohë, pjesa më e madhe e të anketuarve (34.24%), mendojnë se këtë proces e kryejnë shtete të tjera përveç Kinës, Iranit, Rusisë dhe Turqisë.

Figura 8. Cilët nga faktorët e mëposhtëm mendoni se ndikojnë në mënyrë të padrejtë në rezultatin e zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj 2023?



Anketuesit e KShH-së pyetën të anketuarit sa i takon faktorëve të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të padrejtë në rezultatin e zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023. Nëpërmjet një pyetje të mbyllur me alternativat kryesore të identifikuara më parë, prej të cilave secili i anketuar mund të zgjidhte maksimalisht tre, 36.48% prej tyre pohuan se partitë politike janë faktori me ndikim më të madh në rezultatin e zgjedhjeve vendore, ndjekur nga 29.58% prej tyre të cilët përmendin krimin

e organizuar si faktorin më ndikues. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 19.74% prej tyre mendojnë se një ndikim të padrejtë në rezultatin e zgjedhjeve kanë edhe institucionet shtetërore, ndërkohë që vetëm 5.37% kanë pohuar se nuk ka faktorë ndikues. Këto të dhëna për perceptimin qytetar të ndikimeve të padrejta në rezultatin e zgjedhjeve vendore, janë njëkohësisht shqetësime serioz ndaj demokracisë në vend, e cila buron pikërisht nga vullneti i zgjedhësve i shprehur me anë të së drejtës së votës.

3.SHITBLERJA E VOTËS


Shitblerja e votës është një fenomen shqetësues i cili ka qenë i pranishëm në pjesën dërrmuese të proceseve zgjedhore të realizuara në Shqipëri. Ky fenomen qëndron pashmangshmërisht i ndërlidhur me probleme të ndryshme të shoqërisë shqiptare, siç janë: korrupsioni, varfëria, mungesa e edukimit zgjedhor, presionet apo kërcënimet, të cilat ushtrohen nga faktorë të ndryshme ndikues.

Fenomeni i shitblerjes së votës ose siç njihet ndryshe korrupsioni aktiv dhe korrupsioni pasiv në zgjedhje parashikohet edhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë si një vepër penale dhe dënohet me burg nga një deri në pesë vjet (nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal).

Shitblerja e votës është denoncuar shpeshherë nga vetë partitë politike, gazetarët, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti ndërkombëtar (përfshirë përfaqësues të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare të ndryshme në vend), prandaj KShH e ka vlerësuar të rëndësishme për të pyetur qytetarët e anketuar sa i takon aspekteve të ndryshme lidhur me shitblerjen e votës.

Figura 9. A ju janë ofruar para, ushqime, produkte të tjera apo premtime në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023?

A ju janë ofruar para, ushqime, produkte të tjera apo premtime në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023?



Së pari, KShH pyeti të anketuarit nëse u ishin ofruar para, ushqime apo premtime të ndryshme në këmbim të votës. Nga të dhënat rezulton shqetësues fakti se rreth 209 të anketuar apo 19.2% e tyre ka pohuar se kanë marrë oferta të tilla kundrejt 74.5%, të cilët kanë konfirmuar se nuk u janë ofruar para, ushqime, produkte apo ndonjë premtim në këmbimit të ushtrimit të votës në një mënyrë të caktuar. Rreth 6.3% e të anketuarve refuzuan të pohojnë apo mohojnë këtë fenomen duke ngritur dyshime të arsyeshme, mbi ekzistencën e fenomenit, si dhe frikës për ti denoncuar oferta të tilla në këmbim të votës.


Tabela 1. A ju janë ofruar para, ushqime, produkte të tjera apo premtime në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023? (të dhëna sipas bashkive)

Bashkia	Jo	Nuk dëshiroj të përgjigjem	Po
Berat	45.65%	2.17%	52.17%
Dibër	66.67%	23.53%	9.80%
Durrës	70.91%	3.64%	25.45%
Elbasan	90.20%	3.92%	5.88%
Fier	88.00%	4.80%	7.20%
Gjirokastrë	90.91%	0.00%	9.09%
Kamzë	60.00%	0.00%	40.00%

Korçë	95.65%	0.00%	4.35%
Kukës	75.68%	2.70%	21.62%
Lezhë	75.51%	6.12%	18.37%
Malësi e Madhe	70.73%	7.32%	21.95%
Pogradec	51.11%	20.00%	28.89%
Shkodër	54.55%	2.27%	43.18%
Tiranë	80.57%	6.71%	12.72%
Vlorë	44.78%	7.46%	47.76%
Gjithsej	74.52%	6.26%	19.23%

Në një vështrim krahasues mes Bashkive ku është evidentuar më së shumti ky fenomen tek qytetarët, rezulton se renditet në vend të parë Berati ku 52.7% e të anketuarve kanë pohuar një fenomen të tillë ndjekur nga Vlora (47.7%) dhe Shkodra (43,18%).


Figura 10.1 A keni dijeni nëse ndaj personave të rrethit tuaj familjar apo shoqëror janë ofruar para, ushqime, produkte të tjera apo premtime në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj?



Duke marrë në konsideratë se ndonjëherë qytetarët mund të përballen me frikën për të pohuar se u janë ofruar përfitime të ndryshme në këmbim të votës, KShH i pyeti të anketuarit nëse ata kishin dijeni për persona të rrethit të tyre familjar apo shoqëror, të cilëve u janë ofruar përfitime si para, produkte të ndryshme apo premtime. Në ndryshim nga pohimet më sipër për eksperiencën personale, 44.71% e të anketuarve apo 486 prej tyre pohuan se kanë dijeni për oferta tilla. Më një diferencë shumë të vogël, 46.55% e të anketuarve e mohuan një gjë të tillë, kundrejt 8.74% apo 85 të anketuarve që kanë preferuar të mos përgjigjen.

Mjetet dhe format që përdorin palët e interesuara për blerjen e votave të qytetarëve janë të llojeve të ndryshme. 19.2% e të anketuarve të cilët pohuan se u janë ofruar të mira në këmbim të votës u pyetën gjatë pyetësorit sa i takon mjeteve që u janë ofruar në këmbim të votës, nga ku rezultoi se për 39.03% mjeti kryesor i ofruar në këmbim të votës janë paratë. Ofrimi i një vendi pune për veten apo familjarët është një tjetër mjet që përdoret për blerjen e votës ku 25.31% kanë pohuar këtë fakt. Ndërkohë, 16.76% të tjerë kanë pohuar presionin për të mbajtur vendin e punës, pavarësisht se ky veprim nuk kualifikohet si shitblerje por sipas nenit 328/a, paragrafi 3 të Kodit Penal “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”. Pjesa tjetër e të anketuarve pohuan se u janë ofruar edhe ushqime e ndihma materiale (16.54%) ndërsa një pjesë më e vogël (2.36%) pohojnë ekzistencën e kërcënimeve nga persona të përfshirë në veprimtari kriminale për ofrimin e votës së tyre.


Figura 10.4. Cilat janë mjetet apo format që janë përdorur më shumë për shitblerjen e votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj?



KShH gjithashtu i pyeti të anketuarit lidhur me personat të cilët u kanë ofruar blerjen e votës së tyre. Nga të dhënat përfundimtare rezulton se 42.75% e të anketuarve pohuan se këta persona janë të ashtuquajturit ‘patronazhistë’. Në një kuptim të gjerë, pyetësi ofroi përkufizimin e mëtejshëm për patronazhistët “*persona të lidhur me partitë politike të cilët kanë si detyrë që të informojnë mbi territorin që mbulon, për tendencat politike të individëve dhe për të lobuar për partinë të cilës i përkasin*”.


Ndërkohë, sa i takon kategorive që kontaktojnë qytetarët për blerjen e votës, 27.45% prej të anketuarve identifikuan punonjësit e administratës publike si një prej grupeve shpesh të përfshira në shitblerjen e votës së qytetarëve duke ngritur dyshime për integritetin e administratës publike në vend. Në bazë të ligjit nr. 90/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore’ ‘*Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore*’. ‘Një angazhim i tillë i të punësuarve pranë administratës shtetërore dëmton imazhin institucional përballë publikut dhe ndikuar në perceptimin e politizimit të saj.

Figura 10.5 Në cilën prej nënkategorive të mëposhtme përfshihen njerëzit që ju kanë kontaktuar për të blerë votën tuaj?




Në kategoritë e personave të tjerë të përfshirë në shitblerjen e votës janë edhe kandidatët për kryetarë bashkie apo këshilla bashkiakë (12.67%), biznesmenë (10.72%) si dhe persona të njohur për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale (6.41%).

Figura 11.1 A ju është kërkuar të fotografoni votën tuaj në dhomën e fshehtë, për zgjedhjet vendore të 14 Majit?



KShH gjithashtu pyeti të anketuarit nëse u është kërkuar të fotografojnë votën e tyre në dhomën e fshehtë për zgjedhjet e 14 Maj 2023. Vlen të theksohet se shkelja e fshehtësisë së votimit nga zgjedhësit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet, ndërkohë që nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, përbën vepër penale dhe dënohet nga një vit deri në katër vjet me burgim (neni 327 i Kodit Penal, paragrafi 1 dhe 3). Nisur nga të dhënat e anketës, rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve (89.3%) kanë pohuar se nuk i është kërkuar fotografimi i votës së tyre. 6.7% e të anketuarve pohojnë se u është kërkuar të fotografojnë votën ndërkohë që 4% e tyre kanë refuzuar të përgjigjen.

Figura 11.2. Nëse ju është kërkuar të fotografoni votën tuaj në dhomën e fshehtë, për zgjedhjet vendore të 14 Majit - cilit statusi i punësimit të të anketuarit?



KShH krahasoi përgjigjet e 74 të anketuarve (ose 6.7% e totalit) të cilët kanë pohuar se u është kërkuar të fotografojnë votën e tyre në dhomën e fshehtë me statusin e punësimit të tyre. Nga të dhënat rezulton se 27.4% prej tyre janë të punësuar në sektorin privat, ndërkohë që 19.2% janë punonjës në institucione shtetëror. Rreth 23.3% e të anketuarve të cilëve u është kërkuar të fotografojnë votën janë të vetëpunësuar, ndërsa 15.1% e tyre të papunë.

Tabela 2. A ju është kërkuar të fotografoji votën tuaj në dhomën e fshehtë, për zgjedhjet vendore të 14 Majit – sipas bashkive.

Bashkia	Jo	Nuk dëshiroj të përgjigjem	Po
Berat	97.83%	2.17%	0.00%
Dibër	70.59%	15.69%	13.73%
Durrës	100.00%	0.00%	0.00%
Elbasan	96.08%	0.98%	2.94%
Fier	95.20%	3.20%	1.60%
Gjirokastrë	95.45%	4.55%	0.00%
Kamzë	100.00%	0.00%	0.00%
Korçë	97.83%	0.00%	2.17%
Kukës	83.78%	2.70%	13.51%
Lezhë	91.84%	2.04%	6.12%

Malësi e Madhe	80.49%	4.88%	14.63%
Pogradec	60.00%	20.00%	20.00%
Shkodër	100.00%	0.00%	0.00%
Tiranë	90.46%	3.53%	6.01%
Vlorë	64.18%	7.46%	28.36%
Gjithsej	89.24%	4.05%	6.72%

Ndërkohë një vështrim krahasues se në cilën prej bashkive të përfshira në anketim rezulton më i zakonshëm fenomeni i fotografimit të votës, lista e bashkive kryesohet nga Vlora (28.36% e të anketuarve), ndjekur nga Pogradeci me 20% prej të të anketuarve, të cilët raportojnë këtë fenomen.

4.SHPËRDORIMI I ASETVE PUBLIKE

Natyra e përdorimit të burimeve publike gjatë periudhës zgjedhore është e limituar me synimin e minimizimit të pabarazive midis partive qeveritare dhe atyre në opozitë. Në nenin 91 të Kodit Zgjedhor parashikohen të gjitha veprimtaritë që lejohen dhe ndalohen të kryhen nga organet publike. Kështu, sipas paragrafit të parë të këtij neni, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*.

Gjatë këtij procesi zgjedhor por dhe në proceset zgjedhore të mëparshme, organizata vendase dhe ndërkombëtare, si dhe monitorues të emëruar nga KQZ, kanë raportuar pranë këtij institucioni mbi raste të evidentuara të shpërdorimit të burimeve publike. KQZ, në vijim të këtyre raportimeve ka marrë ose jo masa konkrete për dënimin e titullarëve të institucioneve, dhe/apo personave përgjegjës për raportimin e aktiviteteve, të cilët janë evidentuar duke vënë në mbështetje të fushatave të ndryshme zgjedhore burimet publike. Në raportin e fundit të monitorimit të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023, KShH ka evidentuar se këto masa nuk janë proporcionale dhe nuk i kanë shërbyer efektivisht parandalimit të mëtejshëm të këtyre aktiviteteve.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë gjithashtu sqaron edhe se çfarë konsiderohet si ‘burim publik’. Kështu, në paragrafin 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor parashikohet se “burime” quhen *asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil*³, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet *përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim*.

Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, përbën vepër penale sipas nenit 328/a të Kodit Penal dhe dënohet me një marzh dënimi me burgim që varion nga 6 muaj deri në 3 vjet, në varësi të formave të veçanta të kësaj vepre që përfshin më së shumti subjekte të posaçme që kryejnë detyra shtetërore ose funksione në administratën shtetërore të cilët marrin pjesë në kundërshtim me ligjin në veprimtari zgjedhore ose detyrojnë nxënësit apo të tjerët për të marrë pjesë në këto veprimtari apo ushtrojnë presion ndaj tyre për të votuar në favor të një subjekti


³ Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

zgjedhor apo kandidati, si dhe përdorimi prej tyre i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, etj.

Për të kuptuar perceptimet lidhur me përdorimin e burimeve publike në zgjedhjet vendore të 14 Majit, KShH, si fillim, pyeti të anketuarit nëse kishin marrë pjesë në takime me natyrë fushate elektorale para datës 13 Prill, që përkon me afatin fillestar të nisjes së fushatës elektorale⁴.

Nga të dhënat e përftuara nga anketimi rezulton se 1 në 4 të anketuar (25.5%) pohuan se kanë qenë pjesëmarrës në takime gjatë fushatës elektorale kundrejt 63.5% të të anketuarve që mohuan marrjen pjesë në këto aktivitete. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 119 prej tyre (11%) kanë refuzuar të përgjigjen.

Figura 12.1. A keni marrë pjesë në takime me natyrë fushatë elektorale për këto zgjedhje vendore (p.sh. takime me partitë politike dhe kandidatët e tyre, etj.), para datës 13 Prill?



Në tabelën nr.3 më poshtë, e cila krahason pjesëmarrjen në takime elektorale me punësimin e të anketuarve, ndër 278 të anketuar që pohuan se kanë marrë pjesë në takime elektorale, afro 1/3 e tyre (35.97%) kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore.

Tabela 3. A keni marrë pjesë në takime me natyrë fushatë elektorale për këto zgjedhje vendore (p.sh. takime me partitë politike dhe kandidatët e tyre, etj.), para datës 13 Prill – Sipas punësimit.


Punësimi	Po
I papunë	15.11%
I vetëpunësuar	13.67%
Në institucion shtetëror	35.97%
Në subjekt privat	23.74%

⁴ Neni 77 i Kodit Zgjedhor; ‘Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore’: Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.

Nuk dëshiroj të përgjigjem 2.88%

Student/Vullnetar 8.63%

Figura 12.2. Nëse keni marrë pjesë në takime me natyrë fushatë elektorale për këto zgjedhje vendore (p.sh. takime me partitë politike dhe kandidatët e tyre, etj.), para datës 13 Prill, cilës bashki i përkasin të anketuarit?



Gjithashtu KShH, evidentoi se prej të anketuarve të cilët pohuan pjesëmarrjen në takime me natyrë elektorale, 22.3% prej tyre janë qytetarë të bashkisë Tiranë, ndjekur nga 16.55% të cilët i përkasin bashkisë Fier, ndjekur nga bashkia Elbasan me 10.43% të anketuarve, dhe bashkia Durrës ku 8.27% kanë pohuar se kanë marrë pjesë në aktivitete elektorale.

Figura 13. Nëse jeni i punësuar në administratën publike, a jeni detyruar të merrni pjesë në fushatën zgjedhore për këto zgjedhje vendore?



KShH, duke marrë në konsideratë ndalimet e përdorimit të burimeve njerëzore për qëllime elektorale nga organet publike të parashikuara në legjislacionin e përshkruar më sipër, i pyeti të anketuarit të cilët janë të punësuar në administratën shtetërore, nëse ishin detyruar të marrin pjesë në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Afro 57.5% e të anketuarve kanë pohuar se nuk janë detyruar për diçka të tillë. Ndërkohë, që 27.3% e të anketuarve pohojnë se janë detyruar të marrin pjesë në fushatën zgjedhore, prej të cilëve:

- i. 9.5% e të anketuarve kanë pohuar një dukuri të tilla gjatë orarit të punës në shkelje të nenit 91, pika 2;
- ii. 17.8% e tyre kanë pohuar se kjo ka ndodhur jashtë orarit të punës, çka bie në fushën e veprimit të nenit 328/a, paragrafi 3 të Kodit Penal. Kodi Zgjedhor ka parashikuar ndalime të pjesëmarrjes së punonjësve të administratës publike edhe në takime elektorale jashtë orarit të punës kur pjesëmarrja është garantuar për shkak të një premtimi ose ofrimi të përfitimeve për nëpunësit publikë, apo dhe si shkak i ushtrimit të presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Rreth 15.2% e të anketuarve kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Tabela 4. Shpërndarja e të anketuarve sipas bashkive ku punonjësit e administratës publike janë detyruar ose jo të marrin pjesë në fushatën zgjedhore.

Bashkia	Jo nuk jam detyruar	Nuk dëshiroj të përgjigjem	Po jam detyruar gjatë orarit të punës	Po jam detyruar, por jashtë orarit të punës
Berat	53.85%	7.69%	0.00%	38.46%
Dibër	60.71%	7.14%	7.14%	25.00%


Durrës	46.51%	11.63%	0.00%	41.86%
Elbasan	60.87%	30.43%	0.00%	8.70%
Fier	64.20%	27.16%	2.47%	6.17%
Gjirokastrë	66.67%	6.67%	0.00%	26.67%
Kamzë	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Korçë	86.67%	6.67%	3.33%	3.33%
Kukës	80.00%	6.67%	0.00%	13.33%
Lezhë	58.82%	17.65%	11.76%	11.76%
Malësi e Madhe	50.00%	8.33%	33.33%	8.33%
Pogradec	26.32%	21.05%	26.32%	26.32%
Shkodër	18.18%	18.18%	18.18%	45.45%
Tiranë	70.59%	11.76%	7.84%	9.80%
Vlorë	26.19%	2.38%	42.86%	28.57%
Gjithsej	57.48%	15.19%	9.58%	17.76%

Personat e punësuar në administratën publike, të cilët kanë pranuar se janë detyruar të marrin pjesë në fushatën zgjedhore për këto zgjedhje vendore gjatë orarit të punës në bashkinë Vlorë zënë pothuajse 42.86% të të anketuarve në këtë bashki, ndjekur nga bashkia Malësi e Madhe me 33.33% e të anketuarve, Pogradec (26.32%) dhe Shkodër (18.18%). Ndërkohë për kategorinë e të anketuarve të cilët pohojnë se janë detyruar të marrin pjesë në fushatë zgjedhore jashtë orarit të punës, përqindjet më të mëdha të të anketuarve në nivel bashkie, shënohen në Bashkinë Shkodër (45.45%), ndjekur nga Bashkitë Durrës (41.86%), Berat (38.46%), Gjirokastrë (26.67%), Pogradec (26.32%) dhe Dibër (25%).

Nisur nga parashikimet ndaluese të Kodit Zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Nga pilotimi i këtij pyetësi në terren përpara lançimit të tij zyrtar, rezulton se punësimi në institucionet publike shihet si një nga mënyrat e përdorura për

të siguruar vota nga partitë. Pas lançimit, KShH pyeti të anketuarit nëse kishin dijeni për punësime në administratën publike si një mënyrë për të ndikuar rezultatin e zgjedhjeve vendore të 14 majit.

Figura 14. Nëse jeni në dijeni të punësimeve të realizuara në shtet apo në Bashkinë ku ju jetoni, për të ndikuar në rezultatin e këtyre zgjedhjeve, kur kanë ndodhur ato:



Siç evidentohet në Figurën 14 më shumë se gjysma e të anketuarve apo 57% kanë pohuar se nuk ishin në dijeni të rasteve të tilla. Megjithatë, mbetet shqetësues fakti se rreth 35.2% e të anketuarve kanë pohuar se janë në dijeni të punësimeve të tilla gjatë periudhës një mujore ose disa muaj para zgjedhjeve të datës 14 maj 2023. Më tej, 7.8% e të anketuarve, pra 85 prej tyre, kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Në një vështrim krahasues të anketuesve të cilët kanë pohuar dijeni për punësime në institucionet publike shtetërore apo vendore sipas periudhës dhe bashkive të përfshira në anketim rezultojnë se 24.36% e të anketuarve në Tiranë pohuan se kanë dijeni për punësime të ndodhura gjatë periudhës një mujore para zgjedhjeve të datës 14 maj (pra gjatë fushatës zgjedhore), ndjekur nga bashkia Durrës me 22.44% të të anketuarve. Sa i takon dijenisë për punësime disa muaj para zgjedhjeve të Maj 2023, Tirana renditet sërisht e para me 19.47% të të anketuarve që pohojnë një fenomen të tillë ndjekur nga 13.27% e të anketuarve në Elbasan dhe 10.62% e të anketuarve në Fier. Bashkia me numrin më të ulët të të anketuarve që kanë pohuar një fenomen të tillë është Korça (1.77% e të anketuarve pohuan dijeni për punësime disa muaj para zgjedhjeve dhe vetëm 1.28% për punësime gjatë periudhës zgjedhore një mujore).

Tabela 5. Nëse jeni në dijeni të punësimeve të realizuara në shtet apo në Bashkinë ku ju jetoni, për të ndikuar në rezultatin e këtyre zgjedhjeve, kur kanë ndodhur ato – Sipas bashkive.

Bashkia	Disa muaj para zgjedhjeve të dt.14 Maj	Gjatë periudhës një mujore, para zgjedhjeve të dt.14 Maj
Berat	7.96%	4.49%
Dibër	1.33%	4.49%

Durrës	7.52%	22.44%
Elbasan	13.27%	7.69%
Fier	10.62%	3.85%
Gjirokastrë	2.21%	0.00%
Kamzë	0.44%	0.00%
Korçë	1.77%	1.28%
Kukës	3.10%	1.28%
Lezhë	3.10%	5.13%
Malësi e Madhe	5.31%	5.13%
Pogradec	6.19%	3.85%
Shkodër	6.64%	8.33%
Tiranë	19.47%	24.36%
Vlorë	9.73%	6.41%
Gjithsej	100.00%	100.00%


Një fenomen shpeshherë i raportuar në proceset e mëparshme zgjedhore lidhet me kryerjen e investimeve të ndryshme në shërbimet publike në periudhën para datës së zgjedhjeve. Zakonisht investime të tilla bëhen për të ndikuar perceptimin publik lidhur me përmirësimet e shërbimeve publike, duke synuar kështu ndikimin direkt apo indirekt në rezultatin e zgjedhjeve. Në zgjedhjet vendore, ky fenomen është edhe më impaktues pasi investime të tilla janë më pranë qytetarëve duke ndikuar në perceptimin dhe zgjedhjen e një kandidati si kryetar i bashkisë ku ata jetojnë. Kështu, KShH pyeti të anketuarit nëse kishin vënë re apo ishin në dijeni të përmirësimeve të shërbimeve publike duke nisur nga muaji Janar deri para zgjedhjeve të datës 14 Maj të këtij viti.

Figura 15.1. A jeni në dijeni të përmirësimeve të kryera në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, hapësirat e gjelbra publike, pedonale, apo në institucionet ku ofrohen shërbime publike (si spitale, shkolla etj), duke filluar nga muaji Janar i këtij viti deri para zgjedhjeve të datës 14 Maj?



Nga të dhënat e përftuara nga anketimi, rezulton se më shumë se 1 në 2 të anketuar apo 57.9% e tyre pohojnë se kanë vënë re përmirësime të kryera në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, hapësirat e gjelbra publike, pedonale, apo në institucionet ku ofrohen shërbime publike (si spitale, shkolla etj), duke filluar nga muaji Janar i këtij viti deri para zgjedhjeve të datës 14 Maj, krahasuar me 42.1% e të anketuarve, të cilët kanë pohuar se nuk kanë dijeni për diçka të tillë.

Figura 15.2. Nëse përgjigja e pyetjes së mësipërme është po, specifikojë në ç'drejtim dhe përafërsisht në cilin muaj:



KShH gjithashtu u interesua se në ç'drejtim zgjedhësit kanë vënë re përmirësime të shërbimeve publike. Investime në infrastrukturën rrugore, fasada pallatesh, rikonstruksione të godinave publike, etj janë më të dukshme e më të prekshme nga qytetarët, ndaj vihet re edhe një tendencë e organeve publike për të bërë investime të tilla me qëllim ndikimin e zgjedhësve në ushtrimin e të drejtës së votës.

Nga të anketuarit që kanë pohuar se kanë dijeni mbi përmirësimet e kryera, rezulton se shumica e tyre, 73.61% janë shprehur se kryesisht shërbimet e përmirësuar dhe investimet kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore. Nga përgjigjet e të anketuarve rezulton se përmirësimet në infrastrukturën rrugore lidhen me shtrimet e rrugëve, krijimin e korsive të biçikletave, ndriçimin e rrugëve, vijat e bardha, etj. Gjithashtu, rreth 8% e të anketuarve kanë pohuar edhe investime në fasada pallatesh, hapësira publike apo rikonstruksione të ndryshme. Të anketuarit kanë evidentuar rikonstruksione të godinave publike (p.sh. teatri apo kinemaja lokale), krijimin e hapësirave të gjelbërta, termoizolimim dhe përmirësimi i fasadës së jashtme, lysterjen dhe rikonstruksionin e

shkollave, investime në sistemin e ngrohjes në shkolla, etj. Përmirësime të shërbimeve të tjera të pohuara nga 15.25% e të anketuarve lidhen me investimet në pastrimin e qytetit apo fillimin e projekteve të reja, të cilat nuk kanë vijuar pas zgjedhjeve⁵. 3% e të anketuarve gjithashtu kanë pohuar përmirësim në ujësjellës dhe kanalizime duke evidentuar investime të reja në këtë drejtim para zgjedhjeve.

Një fenomen i evidentuar nga qytetarët gjatë periudhës para zgjedhore është edhe pezullimi e, më pas, përshpejtimi i mbarimit të punimeve të investimeve, për të cilat qytetarët kanë evidentuar se mund të kishin përfunduar në një kohë më të hershme para periudhës para zgjedhore (p.sh. disa qytetarë kanë evidentuar përfundimin e përshpejtuar të ndërtimit të trotuarit në lagjen e Astirit në Tiranë pas më shumë se një viti që kishin filluar punimet).

Pavarësisht se neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor⁶ është interpretuar si një kufizim që shtrin efektet e tij në zgjedhjet parlamentare dhe jo ato të qeverisjes vendore, zgjedhësit perceptojnë si ndikim rritjen apo premtimin për rritjen e rrogave të kategorive të ndryshme të nëpunësve apo të pensioneve.

Sa i takon periudhës se kur janë kryer përmirësime të tilla në shërbimet publike, rezulton se qytetarët pohojnë nisjen e investimeve të tilla që prej shpalljes së datës së zgjedhjeve në vitin 2022 me një tendencë në rritje për investime të tilla prej Janarit 2023, duke kulmuar në periudhën prill-maj e deri pak ditë para datës së zgjedhjeve të 14 maj 2023.

Tabela 6. Dijeni të përmirësimeve të kryera në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, hapësirat e gjelbra publike, pedonale, apo në institucionet ku ofrohen shërbime publike (si spitale, shkolla etj), duke filluar nga muaji Janar i këtij viti deri para zgjedhjeve të datës 14 Maj – sipas bashkive.

Bashkia	Jo	Po
Berat	30.43%	69.57%
Dibër	45.10%	54.90%

⁵ Si psh, hapja se kanalizimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe ndalimi i punimeve pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

⁶ Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

Durrës	45.45%	54.55%
Elbasan	39.22%	60.78%
Fier	65.60%	34.40%
Gjirokastrë	72.73%	27.27%
Kamzë	20.00%	80.00%
Korçë	43.48%	56.52%
Kukës	10.81%	89.19%
Lezhë	20.41%	79.59%
Malësi e Madhe	41.46%	58.54%
Pogradec	55.56%	44.44%
Shkodër	15.91%	84.09%
Tiranë	36.04%	63.96%
Vlorë	61.19%	38.81%
Gjithsej	42.13%	57.87%

Në një vështrim krahasues të bashkive rezulton se shumica e të anketuarve në qytetet në vijim kanë pohuar dijeni për investime të reja në periudhën para zgjedhjeve: bashkia Kukës kryeson me 89.19% të të anketuarve që pohojnë një fenomen të tillë ndjekur nga Bashkitë Shkodër (84.09%), Kamzë (80%), Lezhë (79.59%). Nga bashkitë ku një fenomen i tillë është më pak i evidentuar janë bashkia Gjirokastrë ku 72.73% kanë mohuar dijeni për investime të tilla, ndjekur nga bashkitë Fier (65.6%), Vlorë (61.19%), Pogradec (55%).

Figura 16. A jeni në dijeni të ndikimeve nga personel i administratës arsimore (punonjës të ZVA, mësues, pedagogë, etj.) mbi të rinjtë (nxënës/studentë) për të votuar drejt një subjekti të caktuar politik, ose për të ndikuar tek prindërit/të afërmit e tyre, në kuadër të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të dt.14 Maj?




Kodi ynë Zgjedhor parashikon gjithashtu mbrojtjen e nxënësve të shkollave dhe parandalimin e përdorimit të tyre gjatë fushatës zgjedhore, duke sanksionuar si shkelje detyrimin dhe organizimin gjatë orarit mësimor, premtimin apo ofrimin e përfitimeve dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre. KShH pyeti të anketuarit nëse kishin dijeni të ndikimeve të mundshme të ushtruara nga punonjësit e administratës arsimore ndaj nxënësve apo prindërve të tyre për të votuar një subjekt të caktuar në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga të dhënat rezulton se rreth 79.3% e të anketuarve kanë mohuar një ndikim të tillë. Megjithatë, statistikatat tregojnë afro 20.7% e tyre, ose një shifër befasuese prej 1 në 5 të anketuar, që ka pranuar se ka dijeni të rasteve të tilla.

5.DENONCIMET DHE BESUESHMËRIA E ZGJEDHËSVE TEK INSTITUCIONET

Denoncimi nga qytetarët është parashikuar në nenin 123/3 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *‘Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave, që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt KQZ-në.’* Legjislacioni zgjedhor gjithashtu parashikon mbrojtje dhe garanci për denoncuesit të ngjashme me mbrojtjet e ofruara për sinjalizuesit (konfidencialitet, mbrojtje nga veprimet arbitrare të punëdhënësve etj.). Në paragrafin nr. 2 të nenit 123/3 të Kodit Zgjedhor parashikohet se *‘Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë sipas pikës 1 të këtij neni mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.’*

KQZ është organi përgjegjës për miratimin e modelit të denoncimit, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga denoncuesit. Nisur nga të dhënat e këtij anketimi, KShH vlerëson se KQZ duhet të ndërmarrë nisma për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve sa i takon ndalimeve të sanksionuara në legjislacionin zgjedhor dhe përgjegjësive të saj lidhur me to, çka do të kontribuonte në rritjen e rasteve të denoncimeve dhe sipas rastit, sanksionimin prej KQZ-së në vijim të një hetimi administrativ objektiv dhe të gjithanshëm, të subjekteve që kanë kryer këto shkelje. Për të realizuar këtë, është e rëndësishme gjithashtu që KQZ të ndajë informacione cilësore dhe sasiore, periodike me publikun, për numrin e denoncimeve, objektin e tyre, rezultatet e hetimit administrative dhe vendimmarrjen. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve në procesin e denoncimit.


Figura 17. Si do i vlerësonit njohuritë tuaja mbi shkeljet të cilat parashikon Kodi Zgjedhor dhe legjislacioni zgjedhor?



KShH pyeti të anketuarit lidhur me njohuritë e tyre rreth shkeljeve që parashikon legjislacioni zgjedhor. Të dhënat e përftuara nga ky seksion përputhen me të dhënat më sipër ku KShH pyeti të anketuarit lidhur me njohuritë rreth parashikimeve të legjislacionit zgjedhor. Kështu, rezultojnë pjesa më e madhe e të anketuarve kanë njohuri për shkeljet në fushën e zgjedhjeve. Rreth 33.3% të anketuarve vlerësojnë se kanë njohuri të mira për shkelje të tilla, ndjekur nga 33.03% të cilët vlerësojnë se kanë njohuri të mjaftueshme, dhe 21.8% e të anketuarve të cilët pohojnë për njohuri shumë të mira apo të shkëlqyeshme për shkeljet në fushën e zgjedhjeve. Vetëm 11.87% e të anketuarve pohuan për njohuri të dobëta për shkeljet e legjislacionit zgjedhor. Sërisht në këtë seksion vlen për t'u përmendur se këto rezultate janë të bazuara në vetëvlerësimin subjektiv të njohurive nga qytetarët dhe kështu mund të bien pre e paragjykimave të vetvetes.

Pavarësisht nga vetëvlerësimi shumë pozitiv, në tërësi nga veprimtaria e tij, KShH vlerëson se njohuritë e qytetarëve për legjislacionin janë në nivele relativisht të ulëta. Kjo gjen pjesërisht mbështetje në interpretimin krahasues të të dhënave të kryqëzuara të anketimit, sipas të cilave vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve denoncon shkeljet e evidentuara. Në figurën 18, evidentohet se 49.5% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë denoncuar pasi nuk kanë qenë në dijeni të asnjë shkeljeje. Por një pjesë e konsiderueshme, rreth 43.7% e të anketuarve kanë pohuar se edhe pse kanë qenë në dijeni të shkeljeve, nuk kanë bërë asnjë denoncim apo ankesë, rezultat të cilin KShH e vlerëson tejet shqetësues. Nga të dhënat rezultojnë se vetëm 4.57% e të anketuarve kanë denoncuar shkelje në fushën e zgjedhjeve duke ju drejtuar ose Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me ankesë ose policisë e prokurorisë me kallëzim penal.


Figura 18. A keni denoncuar pranë institucioneve përgjegjëse, shkeljet e legjislacionit zgjedhor, në kuadër të këtyre zgjedhjeve vendore?



KShH pyeti të anketuarit⁷ për arsyet që i pengonin apo kufizonin të ankoreshin apo të denonconin pranë institucioneve përgjegjëse. Në analizën e të dhënave të përfuara nga pyetja më poshtë, në grafikun e figurës nr. 19 rezulton se arsyet kryesore të cilat pengojnë denoncimet nga qytetarët janë mungesa e besimit, neglizhimi i situatës, frika nga pasojat dhe mungesa e informacionit.

Figura 19. Nëse keni qenë dëshmitarë të një krimi të lidhur me këto zgjedhje vendore dhe nuk jeni ankuar pranë institucioneve, përse ndodh kjo?

⁷ Kategorinë që nuk kishte bërë denoncim edhe pse ishte në dijeni të shkeljeve.



Ndër këto arsye, 44.03% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë besim mjaftueshëm tek institucionet, se denoncimet apo ankesat e tyre do të trajtohen prej tyre, në mënyrë të drejtë duke ndërmarrë masat e duhura për personat që kryejnë shkelje apo krime zgjedhore. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, pothuajse 1 në 4 persona pohojnë se janë indiferent ndaj ngjarjeve të tilla dhe për këtë neglizhojnë denoncimin. Ndërkohë, rreth 16.87% e të anketuarve kanë frikë nga pasojat apo veprimet hakmarrëse që mund t'u vinë atyre apo edhe familjarëve nga subjekte si punëdhënësi, institucionet publike, organizata kriminale, etj. KShH vlerëson si thelbësor edukimin e qytetarëve me kulturën e denoncimit, si dhe marrjen e masave efektive nga institucionet përgjegjëse për ndëshkimin e shkelësve të ligjit me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucionet.

Tabela 7. Shpërndarja e të anketuarve sipas punësimit dhe përgjigjeve më sipër.

Punësimi	E kam neglizhuar	Kam frikë nga pasojat që mund të vijnë (mund të më heqin nga puna mua apo familjarët, mund të më bëhet presion nga partitë politike apo personat e përfshirë në krim, etj)	Nuk kam besim se institucionet do ndërmarrin veprimet e duhura, në zbatim të ligjit	Nuk kam patur informacion ku të drejtohem
I papunë	31.03%	10.34%	41.38%	17.24%
I vetëpunësuar	21.62%	18.02%	45.05%	15.32%
Në institucion shtetëror	23.97%	25.62%	38.02%	12.40%

Në subjekt privat	22.22%	14.98%	52.17%	10.63%
Nuk dëshiroj të përgjigjem	25.58%	13.95%	46.51%	13.95%
Student/Vullnetar	34.72%	18.06%	31.94%	15.28%
Gjithsej	25.52%	16.87%	44.03%	13.58%

Në një vështrim krahasues sa i takon punësimit të të anketuarve dhe arsyeve se pse ata nuk denoncojnë shkelje apo krime zgjedhore rezulton se mungesa e besimit të institucionet është arsyeja kryesore tek çdo i anketuar pavarësisht punësimit. Ajo çka vihet re me shqetësim është fakti se ndër kategoritë e punësimit, përqindja më e lartë e personave që kanë frikë nga pasojat që mund t'ju vijnë nga denoncimi janë personat e punësuar në institucionet shtetërore. Kjo statistikë është treguese e perceptimit që ekziston për veprimet arbitrare nga organet shtetërore si dhe e mungesës së mbrojtjes efektive të personave që denoncojnë konform ligjit.

KShH gjithashtu pyeti të anketuarit lidhur me vlerësimin e tyre për veprimtarinë e organit të Prokurorisë. Nga të dhënat e anketimit të evidentuara në figurën më poshtë, rezulton se 1 në 2 persona apo 50.23% e të anketuarve vlerësojnë se Prokuroria nuk i heton krimet zgjedhore në mënyrë të menjëhershme dhe të paanshme. Kjo e dhënë përputhet me gjetjet e mësipërme për mungesën e besimit të qytetarëve se institucionet do përmbushin përgjegjësitë e tyre ligjore. 27.41% e të anketuarve pohojnë se nuk e dinë nëse Prokuroria i heton krimet zgjedhore në mënyrë të drejtë kundrejt 22.36% e të anketuarve të cilët e vlerësojnë pozitivisht veprimtarinë e organit të Prokurorisë në hetimin e krimeve në mënyrë të menjëhershme dhe të paanshme. Në vlerësimin e KShH, statistikën e mësipërme, janë tregues shqetësues i perceptimit të një pjese të konsiderueshme të elektoratit, për mungesën e besimit në sistemin e prokurorisë (sipas kompetencës lëndore të ndarë midis prokurorive të juridiksionit të zakonshëm dhe SPAK për hetimin e krimeve zgjedhore).

Figura 20. A vlerësoni se organi i Prokurorisë heton në mënyrë të menjëhershme dhe të paanshme krimet zgjedhore?




Tabela 8. Qasja e të anketuarve mbi veprimtarinë e Prokurorisë sipas bashkive ku ata votojnë.

Bashkia	Jo	Po	Nuk e di
Berat	76.09%	6.52%	17.39%
Dibër	29.41%	15.69%	54.90%
Durrës	65.45%	16.36%	18.18%
Elbasan	58.82%	20.59%	20.59%
Fier	36.00%	43.20%	20.80%
Gjirokastrë	54.55%	4.55%	40.91%
Kamzë	40.00%	40.00%	20.00%
Korçë	17.39%	34.78%	47.83%
Kukës	35.14%	45.95%	18.92%
Lezhë	73.47%	12.24%	14.29%
Malësi e Madhe	48.78%	21.95%	29.27%
Pogradec	53.33%	13.33%	33.33%
Shkodër	79.55%	0.00%	20.45%
Tiranë	46.29%	21.91%	31.80%
Vlorë	46.27%	22.39%	31.34%
Gjithsej	50.23%	22.36%	27.41%


Nga të dhënat e tabelës nr 8, rezulton se personat të cilët nuk besojnë në hetimin shpejtë dhe të paanshëm të krimeve zgjedhore janë të përqendruar kryesisht në qytetet e Shkodrës (79.55%), Beratit (76.09%), Lezhës (73.49%), Durrësit (65.45%), Gjirokastrës (54.55%), Pogradecit (53.33%). Nga të dhënat rezulton gjithashtu se pjesa më e madhe e të anketuarve, të cilët kanë besim te hetimi i organit të Prokurorisë janë në Kukës (45.95%), Fier (43.20%) dhe Kamzë (40%).

6. FINANCIMET E DYSHIMTA TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE (PARTIVE POLITIKE)

Burimet e financimit të subjekteve zgjedhore për fushatën e tyre kanë qenë shpesh në fokus të diskutimit publik, nisur nga fakti se shpenzimet e partive politike gjatë fushatës shpeshherë konsideroheshin si të pajustificueshme dhe burimet e tyre si të errëta apo të paligjshme. Në fakt, Kodi Zgjedhor parashikon disa kategori si burime financimi për partitë politike. Në nenin 86 të Kodit Zgjedhor, parashikohen si burime të financimit të fushatës për subjektet zgjedhore: *a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore; b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit; c) dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas nenit 92/1 të këtij ligji; ç) huat ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit.*

KShH pyeti të anketuarit fillimisht se si i konsideronin ata shpenzimet që partitë politike kanë bërë për fushatën zgjedhore për zgjedhjet vendore të 14 maj 2023.

Figura 21. Si do ti vlerësoni shpenzimet që partitë politike kanë bërë për zgjedhjet vendore të dt.14 Maj 2023?




Nga të dhënat e anketimit rezulton se shumica e të anketuarve, rreth 55.1% e tyre i vlerësojnë shpenzimet e kryera për fushatë si të tepruara apo shume të tepruara. 28.89% e të anketuarve i konsiderojnë shpenzimet e kryera si normale, ndërkohë që 16.01% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë dijeni.

Gjithashtu, KShH pyeti të anketuarit nëse kishin dijeni të financimeve të dyshimta të partive politike apo kandidatëve të tyre. Pjesa më e madhe, rreth 71.3% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë dijeni për financime të paligjshme. Ndërkohë që 26.77% apo 291 të anketuar pohuan se kanë dijeni për ekzistencën e financimeve të paligjshme apo të dyshimta të partive politike. Rreth 1.9% e të anketuarve kanë shprehur opinione të ndryshme sa i takon financimit të paligjshëm të fushatës zgjedhore, duke u shprehur se kanë dyshime rreth financimit si rrjedhojë e kostove të


materialeve të përdorura gjatë fushatës, si dhe në sajë të mungesës së transparencës nga ana e partive.

Figura 22.1. A jeni në dijeni të financimeve të paligjshme (dyshimta) të partive politike dhe kandidatëve të tyre, për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj?




291 të anketuarit që u shprehën se kanë dijeni rreth financimeve të paligjshme apo të dyshimta, u pyetën rreth burimit të financimeve të partive politike. Shumica e të anketuarve, 82% e tyre u shprehën se burimi kryesor i financimeve të paligjshme vjen si rezultat i korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndjekur nga 9.89% që rendisin bizneset si financues dhe një numër i ulët zgjedhësish afro 7% mendojnë se Rusia mund të financojë subjekte zgjedhore të caktuara, për të ndikuar në zgjedhje.

Figura 22.2. Nëse përgjigja e pyetjes së mësipërme është po specifikoj arsyen pse mendoni që këto financime janë të dyshimta dhe burimin e këtyre financimeve, p.sh. nga vende të huaja, bizneset, krimi i organizuar, korrupsioni, etj:



Të anketuarit kanë dhënë një sërë përgjigjesh lidhur me arsyen se pse i konsiderojnë financimet të dyshimta apo të errëta, si dhe burimet e tyre, si psh, nuk janë të deklaruar, tejkalojnë buxhetet në dispozicion, nuk ka transparencë nga subjektet zgjedhore, janë të pajustificueshme krahasuar me standartin e jetesës në vendin tonë, si rrjedhojë e përdorimit të tyre për shitblerjen e votave, si dhe nisur nga lajmet në media për lidhjen e partive politike apo kandidatëve të tyre me organizata kriminale.

Figura 22.3. Nëse jeni në dijeni të këtyre financimeve të dyshimta/paligjshme, nga e keni marrë këtë informacion?



Nisur nga perceptimi publik për financimet e dyshimta apo të paligjshme të fushatës zgjedhore, KShH pyeti të anketuarit lidhur me burimin e informacionit në bazë të të cilit kishin krijuar këtë ide. Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve pohojnë se informacioni i ndarë në media është burimi i tyre kryesor. Në një pyetje të hapur ku qytetarët mund të evidentonin burime të ndryshme për këtë informacion, të anketuarit kanë referuar edhe burime të tjera të cilat lidhen me personat e angazhuar në veprimtari politike si anëtarë apo simpatizantë të partive politike. Zgjedhësit e anketuar që janë në dijeni të këtyre informacioneve gjithashtu kanë pohuar si burim rrjetet sociale, familjarët apo miqtë e tyre, si dhe në disa raste të pakta prej angazhimit të tyre direkt me fushatën zgjedhore ku janë më të ekspozuar ndaj informacioneve të tilla.

Sondazh

Për matjen e perceptimit të zgjedhësve lidhur me influencat e padrejta në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Majit 2023

Hyrje e Pyetësorit (për t'i informuar qytetarët për natyrën e influencave të padrejta)

Influencat apo veprimet e padrejta, mund të jenë të jashtme ose të brendshme dhe synojnë të deformojnë rezultatet e procesit zgjedhor, dëmtojnë lirinë dhe barazinë e votës, duke avantazhuar në mënyrë të padrejtë apo të pandershme forca të caktuara politike ose kandidatë të tyre.

Influencat e jashtme mund të vijnë si rezultat i ndikimeve nga shtete të tjera të njohura për regjimet diktatoriale ose autokrate, duke sjellë edhe efekte destabilizuese në drejtim të demokracisë në shtetin e synuar.

Influencat e brendshme, mund të vijnë për shkak të ndikimeve që ka krimi i organizuar si rrjedhojë e interesave të tij për të patur mbështetje politike, të lidhura me pandëshkueshmërinë, pastrimin e parave, tenderat, prokurimet, etj. Si rrjedhojë e këtij ndikimi, ndaj qytetarëve mund të ushtrohet presion për të votuar në favor të një partie politike, mund të ofrohen të mira materiale ose para, në këmbim të votës, një fenomen i quajtur shitblerja e votës.

Për qëllime të lidhura me interesa financiarë dhe avantazhimet në partneritete publike apo private, tendera, prokurime, krijime të lehtësirave fiskale, influencues mund të jenë edhe bizneset, me anë të mbështetjes financiare që japin ndaj kandidatëve apo partive politike.

Një formë tjetër e ushtrimit të influencave të padrejta është me anë të presionit që ofrohet mbi administratën publike dhe familjarëve të tyre, për të marrë pjesë në veprimtari politike, për të votuar partinë politike që është në pushtet, apo premtime që i bëhen zgjedhësve se nëse do të votojnë partinë politike do të punësohen në administratën publike.

SEKSIONI 1: Njohuritë e përgjithshme

1. Si i vlerësoni njohuritë që keni për legjislacionin zgjedhor?

- a. Të shkëlqyeshme
- b. Shumë të mira
- c. Të mira
- d. Mjaftueshëm
- e. Dobët

2. A mendoni se shtete të huaja ndërhyjnë në mënyrë të padrejtë në proceset zgjedhore në Republikën e Shqipërisë?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk kam dijeni

3. Nëse po, cilat nga këto shtete mendoni se ndikojnë në mënyrë të padrejtë në zgjedhjet në vendin tonë? (Ju mund të përzgjidhni më shumë se 1 alternativë)

- a. Kina
- b. Irani
- c. Rusia
- d. Tjetër

4. Cilët nga faktorët e mëposhtëm mendoni se ndikon në mënyrë të padrejtë në rezultatin e zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj 2023? (Mund të përzgjidhni më shumë se 1 alternativë)

- a. Krimi i organizuar shqiptar
- b. Krimi i organizuar ndërkombëtar
- c. Partitë politike
- d. Institucionet shtetërore
- e. Organizata ndërkombëtare
- f. Organizata të shoqërisë civile
- g. Shtete të treta
- h. Tjetër

SEKSIONI 2: SHITBLERJA E VOTËS

5. A ju janë ofruar para, të mira materiale apo premtime të tjera në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023?

- a. Po
- b. Jo

c. Nuk dëshiroj të përgjigjem

6. A keni dijeni nëse ndaj personave të rrethit tuaj familjar apo shoqëror janë ofruar para, të mira materiale apo premtime të tjera në këmbim të votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj?

- a. Po
- b. Jo

7. Nëse përgjigja e pyetjes 5 apo 6 është po, në dijeninë tuaj, cilat janë mjetet apo format që janë përdorur më shumë për shitblerjen e votës për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj (mund të përzgjidhen deri në dy alternativa)?

- a. Shumë parash në të holla
- b. Të mira materiale
- c. Vend pune për ju ose familjarët tuaj
- d. Kërcënime nga persona të përfshirë në veprimtari kriminale
- e. Presione për të mbajtur vendin e punës.
- f. Tjetër (specifiko)

8. Nëse përgjigja e pyetjes 5 apo 6 është po, në cilën prej nënkategorive të mëposhtme përfshihen njerëzit që ju kanë kontaktuar për të blerë votën tuaj (mund të përzgjidhen deri në dy alternativa):

- a. Patronazhist (persona të caktuar nga një parti politike në një zonë të caktuar për të identifikuar bindjet politike të zgjedhësve dhe për të lobuar në favor të partisë politike)
- b. Punonjës të Administratës Publike
- c. Kandidatë për kryetar Bashkie ose Këshilla Bashkiakë
- d. Biznesmenë
- e. Persona të njohur si të përfshirë në veprimtari kriminale
- f. Tjetër (specifiko)

9. A ju është kërkuar të fotografoni votën tuaj në dhomën e fshehtë, për zgjedhjet vendore të 14 Majit, si një provë për të mirat materiale që ju janë dhënë apo premtuar në këmbim të saj?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk dëshiroj të përgjigjem

SEKSIONI 3: SHPËRDORIMI I ASETVE PUBLIKE

10. A keni marrë pjesë në takime me natyrë fushatë elektorale (p.sh. premtime për mandatin tjetër, prezantime planesh për qytetin, etj.), para datës 13 Prill (të lidhura me zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj)?

- a. Po (specifiko subjektin zgjedhor që i ka zhvilluar, vendin e takimit dhe periudhën afërsisht)
- b. Jo nuk kam marrë pjesë
- c. Nuk dëshiroj të përgjigjem

11. Nëse jeni i punësuar në administratën publike, a jeni detyruar të merrni pjesë në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj:

- a. Po jam detyruar gjatë orarit të punës
- b. Po jam detyruar, por jashtë orarit të punës
- c. Jo nuk jam detyruar
- d. Nuk jam punonjës i administratës publike
- e. Nuk dëshiroj të përgjigjem

12. Nëse jeni në dijeni të punësimeve të realizuara rishtaz në institucionet apo entet publike të Bashkisë ku ju jetoni, për të ndikuar në zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj, kur kanë ndodhur ato:

- a. Disa muaj para zgjedhjeve të dt.14 Maj
- b. Gjatë periudhës një mujore, para zgjedhjeve të dt.14 Maj
- c. Përpara muajit Janar 2023
- d. Nuk jam në dijeni të rasteve të tilla

13. A jeni në dijeni të përmirësimeve të mundshme të kryera në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, hapësirat e gjelbra publike, pedonale, apo në institucionet ku ofrohen shërbime publike (si spitale, qendra shëndetësore, shkolla etj) para zgjedhjeve të datës 14 Maj?

- a. Po (specifiko në ç'drejtim dhe përafërsisht në cilin muaj)
- b. Jo

14. A jeni në dijeni të ndikimeve nga personel i administratës arsimore (punonjës të ZVA, mësues, pedagogë, etj.) mbi të rinjtë (nxënës/studentë) për të votuar drejt një subjekti të caktuar politik, ose për të ndikuar tek prindërit/të afërmit e tyre, në kuadër të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të dt.14 Maj?

- a. Po
- b. Jo

SEKSIONI 4: DENONCIMET DHE BESUESHMËRIA E ZGJEDHËSVE TEK INSTITUCIONET

15. Si do i vlerësonit njohuritë tuaja mbi Kodin Zgjedhor?

- a. Të shkëlqyeshme
- b. Shumë të mira
- c. Të mira
- d. Mjaftueshëm
- e. Dobët

16. Si do i vlerësonit njohuritë tuaja mbi shkeljet të cilat parashikon Kodi Zgjedhor dhe legjislacioni zgjedhor?

- a. Të shkëlqyeshme
- b. Shumë të mira
- c. Të mira
- d. Mjaftueshëm
- e. Dobët

17. A keni denoncuar pranë institucioneve përgjegjëse, shkeljet e legjislacionit zgjedhor, në kuadër të zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj?

- a. Po, i jam drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me ankesë
- b. Po, i jam drejtuar me kallëzim penal policisë ose prokurorisë
- c. Jo, nuk kam bërë asnjë denoncim apo ankesë, edhe pse kam qenë në dijeni të shkeljeve
- d. Jo, nuk jam në dijeni të asnjë shkeljeje

18. Nëse keni qenë dëshmitarë të një krimi të lidhur me zgjedhjet vendore të dt.14 Maj dhe nuk jeni ankuar pranë institucioneve të sipërpërmendura, përse ndodh kjo?

- a. Nuk kam patur informacion ku të drejtohem.
- b. Kam frikë nga pasojat që mund të vijnë (mund të më heqin nga puna mua apo familjarët, mund të më bëhet presion nga partitë politike apo personat e përfshirë në krim, etj)
- c. Nuk kam besim se institucionet do ndërmarrin veprimet e duhura, në zbatim të ligjit.
- d. E kam neglizhuar

19. A vlerësoni se organi i Prokurorisë heton në mënyrë pro-aktive (me nismën e saj), të menjëhershme dhe të paanshme krimet zgjedhore?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

SEKSIONI 5: FINANCIMET E DYSHIMTA TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE (PARTIVE POLITIKE)

20. A jeni në dijeni të financimeve të paligjshme (dyshimta) të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj?

- a. Po (specifiko arsyen pse mendoni që këto financime janë të dyshimta dhe burimin e këtyre financimeve, psh nga vende të huaja, bizneset, krimi i organizuar, korrupsioni, etj)
- b. Jo

21. Nëse jeni në dijeni të këtyre financimeve, nga e keni marrë këtë informacion?

- a. Media
- b. Persona të angazhuar në veprimtari politike (anëtarë, simpatizantë, etj)
- c. Të tjera (specifiko)

22. Si mendoni se mund të kontribuohet në përmirësimin e transparencës së financimit të fushatës së partive politike dhe në parandalimin e financimeve të dyshimta apo të paligjshme të veprimtarisë së tyre (Mund të përzgjidhet më shumë se një alternativë)?

- a. Burimet dhe shumat e financimit të fushatës të raportohen publikisht nga çdo parti politike, në mënyrë periodike, përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore.
- b. Kodi Zgjedhor të parashikojë që subjektet të marrin financim vetëm nga buxheti i shtetit dhe rrjedhimisht të mos financohen nga subjekte private.
- c. Të ndërgjegjësohen dhe inkurajohen qytetarët që të denoncojnë në KQZ (qoftë edhe në mënyrë anonime) rastet e financimit të dyshimtë të subjekteve zgjedhore.
- d. Nuk kam ndonjë sugjerim
- e. Tjetër (specifiko)

SEKSIONI 6: INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË ANKETUARIT

23. Gjinia:

- a. Grua
- b. Burrë
- c. Tjetër

24. Mosha:

- a. 18–25 vjeç
- b. 26–35 vjeç
- c. 36–45 vjeç
- d. 46-55 vjeç
- e. 56-60 vjeç
- f. 61-64 vjeç
- g. Mbi 65 vjeç

25. Niveli arsimor i përfunduar:

- a. Asnjë
- b. Fillor (klasa 1-5)
- c. I mesëm i ulët (klasa 6-9)
- d. I mesëm i lartë (Gjimnaz)
- e. Arsim Profesional
- f. I lartë
- g. Diplomë pasuniversitare
- h. Doktoraturë

26. Punësimi

- a. Në institucion shtetëror
- b. Në subjekt privat
- c. I vetëpunësuar
- d. I papunë
- e. Student/Vullnetar